



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 29.03.2022, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi dhe votimi i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit” (*Komision përgjegjës*)

**Marrin pjesë:**

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Fadil Nasufi, Laert Duraj, Luljeta Bozo, Ismet Beqiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Lefter Gështenja, Zef Hila, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka dhe Pranvera Resulaj.

**Mungojnë:**

Tatiana Piro, Anduel Tahiraj, Rrahman Rraja, Alqi Bllako, Flamur Hoxha, Fatjon Veizaj dhe Nusret Avdulla.

**Të ftuar:**

Dhimitër Kote - Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Alban Mësonjësi - Drejtor Juridik në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Julinda Bare – Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

## HAPET MBLEDHJA

**Arben Pëllumbi** – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit.

Në rendin e ditës së sotme, sikurse jeni në dijëni, kemi shqyrtimin dhe votimin e projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”.

Relator është zoti Ilir Ndraxhi.

Të ftuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kemi zotin Dhimitër Kote, zëvendësministër, zotin Alban Mësonjësi, drejtor Juridik dhe Julinda Bare, përgjegjëse sektori.

Mirë se erdhët!

Ne e kemi shqyrtuar projektligjin në parim, kemi bërë diskutime, kemi dëgjuar grupet e interesit dhe sot do të fillojmë me shqyrtimin nen për nen.

Tabelat me sugjerimet e bëra nga Komisioni i Integritetit për përputhshmërinë me aktet e Bashkimit Europian i keni përpara. Grupet e interesit kanë bërë disa propozime dhe në kolonën e fundit ka disa përmirësime, që ne si komision, bashkë me shërbimet dhe në rakordim me propozuesit, mendojmë t’i bëjmë këtij projektligji.

Para se të fillojmë me shqyrtimin, do të doja vëmendjen tuaj, sepse propozuesit, duke qenë se janë të njëjtët edhe për rendin e ditës së nesërme, për vreshtarinë dhe verën, kanë kërkuar një shtyrje, sepse janë në bashkëbisedime me grupet e interesit për të gjetur një pikë të përbashkët, ku të konvergjojnë mendimet e të gjithëve për disa formulime. Nëse jeni dakord, ta shtyjme për javën e ardhshme rendin e ditës së nesërme, derisa propozuesit të bien dakord me grupet e interesit për përputhjen e interesave të të gjithëve.

A jeni dakord? Dakord.

Fillojmë me nenin 1, që janë dispozita të përgjithshme.

Nga propozimi i Komisionit të Integritetit, në fund të faqes së parë ne duhet të vendosim shënimin për rregulloret e Bashkimit Europian. Komisioni i Integritetit i ka sjellë plotësisht propozimet në variantin e tabelës dhe këto duhet të vendosen në fund të faqes së parë.

Neni 1 “Qëllimi”.

Në këtë nen nuk ka propozime.

Kush është dakord?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër, zoti Duka.

**Agron Duka** – Unë nuk jam jurist dhe nuk e di nëse kam të drejtë, por duket sikur fjalët në fillim janë të tepërta: “Ky ligj është përafuar pjesërisht”. Unë do të thosha: “Ky ligj është përafuar me rregulloren”, e të tjera.

**Arben Pëllumbi** – Zoti Duka, ajo që shikoni ju është sugjerimi që ka bërë Komisioni i Integrimit për ta vendosur në fund të faqes, nuk është pjesë e ligjit. Duhet të theksojmë se ky ligj është mbështetur pjesërisht në Rregulloren e Bashkimit Europian. Pra, nuk është pjesë integrale e ligjit, por për efekt të teknikës legislative dhe detyrimeve që kemi nga MSA-ja...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në bazë të detyrimeve që kemi kur bëjmë një ligj, ne duhet të theksojmë nëse është me përafrim të plotë apo të pjesshëm. Ky ligj është pjesërisht i përafuar me direktivat dhe Rregulloren e Bashkimit Europian.

Fillojmë me nenin 1.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Në nenin 2 nuk ka ndryshime për fushën e veprimit. Kush është dakord me nenin 2?

Kush është dakord? 8 pro. Kundër? 4 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3.

Në këtë nen ka disa sugjerime.

Komisioni i Integrimit sugjeron që në shkronjat “b” dhe “c”, respektivisht: “Çdo person fizik ose juridik” të hiqet, kur bëhet fjalë për përkufizimin e autoritetit publik. Pra, të lihet: “çdo person juridik”. Ky është sugjerimi i Komisionit të Integrimit, me idenë që autoriteti publik nuk mund të jetë një person fizik.

Gjithashtu, Shoqata e Ekspertëve të Agrobiznesit ka kërkuar të bëhet një përkufizim i GVV-së dhe zonës lider, që të jetë më i plotë.

Ministria komenton se ky përkufizim është bërë në bazë të Rregullores së Bashkimit Europian, ka kaluar në proces konsultimi dhe miratimi. Praktikisht, edhe Komisioni i Integrimit nuk bën sugjerim për të bërë një përkufizim më të saktë se ky që kemi, përveç faktit që duhet të heqim personin fizik.

A keni komente për këtë pjesë?

Zoti Mësonjësi, si mendoni?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, ta heqim fjalën “fizik”, të lëmë vetëm fjalën “juridik”.

Gjithashtu, kemi një propozim nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në pikën 4 të nenit 3. Ata mendojnë se në koncept partneriteti duhet të jetë tripalësh. Kjo është ideja që ata dëshirojnë, por sigurisht, e kanë të plotë riformulimin. Pra, përbëhet nga grupet e partneritetit, por futet edhe partneri civil.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë e kam të shkruar, ndaj më duhet ta them.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Hapeni mikrofonin, ju lutem!

**Alban Mësonjësi** – Përkufizimet që ne kemi paraqitur janë në përputhje me rregulloren. Po ashtu, edhe ndërhyrjet që ka bërë Komisioni i Integritetit janë në përputhje me rregulloren.

Për sa i përket termit partneritet civil, nuk e përmirëson projektligjin dhe nuk është pjesë e kësaj baze ligjore. Çështjet që lidhen me përkufizimet civile janë tek e drejta private, që lidhet me pronat. Propozimi është i pavend, ndaj shprehemi kundër.

**Arben Pëllumbi** – Të gjitha propozimet e Rrjetit Shqiptar të Zhvillimit në këtë pikë kanë të bëjnë pikërisht me partneritetin, për ta kaluar nga dypalësh në tripalësh. Pra, jo publik-privat, por publik-privat dhe civil. Unë ju pyes juve, por as shërbimet e Kuvendit nuk e kanë gjetur me vend këtë gjë.

**Alban Mësonjësi** – “Privatët janë civilë”. Ky term nuk konverton askund.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Arben Pëllumbi** – Shërbimet e Kuvendit më sqarojnë se pjesën private duhet ta përkufizojmë më mirë dhe pjesa private, ku është edhe civilja, të ndahet në dy, sepse janë shoqatat, por mund të jetë edhe partner privat. Në këndvështrimin tim besoj se privati përfshin edhe civilin.

**Alban Mësonjësi** – Kryetar, në nenin 5.2 ka një përkufizim: “Autoritet publike ose grupet e interesit nga sektori privat ose shoqëria civile”. Duke u nisur edhe nga manualët e teknikës legislative, besoj se shqetësimi i tyre është i përfshirë. Pra, ata janë të përfshirë. Në pikën 5.2 është: “ose grupet e interesit nga sektori privat ose shoqëria civile”.

**Arben Pëllumbi** – Atëherë, në nenin 3 pranojmë vetëm ndryshimin e Komisionit të Integritetit, ku heqim fjalët “person fizik” dhe lëmë fjalët “person juridik”.

**Alban Mësonjësi** – Ndërkohë, shqetësimi i rrjetit është ezauruar te pika 5.2.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Arben Pëllumbi** – Kush është dakord me nenin 3, me ndryshimet e propozuara nga Komisioni i Integritetit? 8 vota pro. Kundër? 4 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4 “Parimet e funksionimit”.

Te neni 4, edhe kur kemi diskutuar me grupet e interesit, kemi debatuar faktin që propozuesi e mbështet për 4 parime dhe ata mendojnë të jenë 7 parime, duke bërë edhe propozimin e tyre. Nga shpjegimi që kemi pasur qoftë gjatë seancave të bëra në këtë komision, qoftë edhe nga shtjellimi që është dhënë nga propozuesi në tabelën përkatëse, mendohet që brenda katër parimeve janë të përfshira edhe tri të tjerat.

A ka dikush ndonjë propozim tjetër, apo do t'i qëndrojmë variantit të dhënë nga ministria? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 4 sipas variantit të propozuar nga Këshilli i Ministrave? Kundër? 5 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 5, ku kemi një formulim të pikës 2, me qëllim qartësimin e përmbajtjes. Pra, atë që thamë pak më parë në lidhje me përbërjen ne kemi ...

Po, urdhëroni!.

**Laert Duraj** – Me riformulimin e pikës 2 unë jam shumë dakord, pasi edhe në mbledhjen e kaluar, kur u trajtua kjo çështje, e ngrita si shqetësim, pasi nuk ishte i qartë se si ishte ndarë vendimmarrja, cila do të ishte 49% dhe cila nuk do të ishte. Në këtë rast është përcaktuar qartë se njësitë e vetëqeverisjes vendore, së bashku me autoritete të tjera publike, e theksoj “publike”, përfaqësojnë jo më shumë se 49% të votës, që do të thotë se është e qartë se cila është 51%-shi. Çfarë u diskutua? Ju nuk ishit, pasi atë mbledhje e drejtoi zoti Naçi, por mua më vjen mirë që ai shqetësim që u ngrit tani është i qartë. Pra, dihet se kush është 51%-shi tashmë. 51%-shin e përcaktojnë institucionet e pavarura private, fermerët ose grupet e interesit, pra nuk janë më nga autoritet publike. Kështu që unë, personalisht, e shpreh votën time pro kësaj.

**Arben Pëllumbi** – Kush është dakord me nenin 5, me riformulimin përkatës të pikës 2? Kundër? 5 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 6.

Në nenin 6 kemi një sugjerim, por ministria e ka dhënë shpjegimin. A mund ta thoni edhe një herë, ju lutem?

**Alban Mësonjësi** – Ne i kemi dhënë shpjegimet, kryetar, nisur edhe nga riformulimet e bëra më sipër. Edhe ky shqetësim i grupeve të interesit është tashmë i ezauruar, pra 51%

kontrolli nuk është më nga autoritet publike, por është nga subjektet e tjera jopublike. Pra, në harmoni me ndryshimet e tjera është i ezauruar propozimi, kështu që jemi kundër.

**Arben Pëllumbi** – Kush është dakord me nenin 6, sipas propozimit të Këshillit të Ministrave? Kundër? 5 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7.

Në nenin 7 nuk ka as ndryshime dhe as propozime.

Kush është dakord me nenin 7? Kundër? 5 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8. Edhe në nenin 8 nuk ka ndryshime.

Kush është dakord me nenin 8? 8 vota pro. Kundër? 5 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu II “Organizimi dhe funksionimi i GVV-ve”.

Për nenin 9 nuk ka komente apo ndryshime.

Kush është dakord me nenin 9, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10 “Struktura e GVV-ve”.

Këtu kemi një propozim të bërë nga shërbimet e komisionit.

Në pikën 1 propozojnë këtë riformulim: “GVV-të krijohen dhe funksionojnë si organizata jofitimprurëse me anëtarësi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.”

**Alban Mësonjësi** – Kryetar, dakord!

**Arben Pëllumbi** – Nuk është se ndryshohet, por vetëm për teknikë legjislative riformulimi është bërë më i saktë.

Kush është dakord me nenin 10, sipas propozimit që sapo lexova? Kundër? 5 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 11 “Funksionet e GVV-së”.

Këtu kemi disa propozime të ardhura nga Komisioni i Integritetit.

Në pikën 2, germa “c”, sugjerojnë të riformulohet si vijon: “Përshkrimin e strategjisë dhe objektivave të saj, përshkrimin e karakteristikave inovative dhe të integruara të saj dhe

një hierarki objektivash, duke përfshirë objektivat e matshme për rezultatet. Në lidhje me rezultatet, objektivat mund të shprehen në terma sasiorë ose cilësorë.”

A jeni dakord me këtë riformulim?

**Alban Mësonjësi** – Po, jemi dakord!

**Arben Pëllumbi** – Te paragrafi i dytë, pika 2, gjithashtu shërbimet e komisionit kërkojnë të bëhet një riformulim. Më duket se keni rënë dakord edhe ju me këtë riformulim, që bëhet për teknikë legjislative për ta shprehur më saktë. Pra, për të hequr idenë e të qenit detyrues, për të qenë sugjerues.

**Alban Mësonjësi** – Jemi dakord!

**Arben Pëllumbi** – Gjithashtu, në pikën 3, Komisioni i Integritit, germa “a”, “b”, “c” dhe “ç”, sugjeron që të riformulohen si vijon: “a) Të krijojë kapacitetet e aktorëve lokalë, që përfshin përfituesit e mundshëm për të zhvilluar e zbatuar masa/aktivitete që përfshijnë fuqizimin e kapaciteteve të tyre të hartimit dhe menaxhimit të projekteve”. Gjithashtu, edhe germa “b”, “c” dhe “ç” kanë këtë sens riformulimi.

**Alban Mësonjësi** – Dakord në tërësi me formulimin.

**Arben Pëllumbi** – Kush është dakord me nenin 11, me ndryshimet e propozuara nga Komisioni i Integritit dhe me sugjerimin e bërë për riformulim nga shërbimet e komisionit tonë? 8 vota pro? Kundër? 5 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 11.

Kalojmë te neni 12.

Edhe këtu shërbimet e komisionit sugjerojnë që të kemi një riformulim në pikën 1, të nenit 12, si më poshtë: “Gjatë realizimit të misionit të tij publik, aktivitetet e GVV-së, që financohen nga fonde publike, kryhen në përputhje me parimet e një prokurimi publik efektiv, transparent e llogaridhënës dhe me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe menaxhimin dhe kontrollin financiar.”

**Alban Mësonjësi** – Dakord me formulimin, kryetar, sepse ka të njëjtin synim.

**Arben Pëllumbi** – Kush është dakord me nenin 12, sipas riformulimit që sapo lexova? 8 vota pro? Kundër? 5 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 13.

Në nenin 13 kemi disa komente të bëra nga grupet interesit. Ju, si ministri, keni dhënë komentet përkatëse, ndaj nëse mundeni të na i sqaroni.

**Alban Mësonjësi** – Për definicion një organizatë vullnetare është vetëm nëse palët duan ta themelojnë. Pra, në këtë kuptim edhe angazhimi i njësisve të vetëqeverisjes vendore është vullnetar, pra, ligji nuk i detyron, vetëm nëse ata duan mund ta krijojnë dhe të marrin pjesë në këto organizata. Për definicion organizatat janë një bashkim vullnetar, të cilat janë të pavarura nga ministria dhe nga shteti, kështu që pushteti vendor nëse do, futet dhe nëse nuk do, nuk futet dhe është vendimmarrja e tyre. Pra, nuk cenohet pavarësia e pushtetit vendor, se ky ka qenë shqetësimi, ndaj jemi kundër.

**Arben Pëllumbi** – Kam një sugjerim në pikën 3, të nenit 13: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore pjesëmarrëse në një GVV, të regjistruar siç përcaktohet në këtë ligj, mund të mbështesin financiarisht kostot...”. Ju thoni “mbështesin financiarisht kostot”, ndërkohë që unë sugjeroj që përpara fjalës “mbështesin” të shtohet shprehja “mund të”. Pra, për të hequr gjithmonë këtë definicionin detyrues të gjësë. Meqenëse edhe fryma që ju thatë pak më parë për organizimin që është vullnetar, mendoj të shtojmë shprehjen “mund të”.

**Alban Mësonjësi** – Dakord!

**Arben Pëllumbi** – Kush është dakord me nenin 13, sipas propozimit që sapo bëra? Kundër? 5 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 13.

Te neni 14 nuk kemi ndryshime dhe qëndron varianti i Këshillit të Ministrave.

Kush është dakord me nenin 14? 8 vota pro. Kundër? 5 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu III “Regjistrimi i GVV-ve”.

Neni 15.

Këtu kemi komente edhe nga grupet e interesit, edhe nga shërbimet komisionit.

Në nenin 15, pika 4, shërbimet e komisionit propozojnë këtë riformulim, duke vendosur një afat për plotësimin e dokumentacionit.

**Alban Mësonjësi** – Zoti kryetar, të shprehemi?

Jemi dakord me riformulimin, pra me vendosjen e afatit.

**Arben Pëllumbi** - Atëherë, po e lexoj të gjithë riformulimin e pikës 4, të nenit 15: “Në rast të mospërbushjes së kërkesave të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, struktura përgjegjëse për regjistrimin e GVV-së njofton GVV-në përkatëse për këtë mospërbushje dhe cakton një afat 6 mujor për plotësimin e tij. Në rast se në përfundim të këtij afati konstatohet se nuk janë përmbushur ende kërkesat sipas pikës 2 të këtij neni, ministri refuzon



autorizimin dhe urdhëron moskryerjen e regjistrimit në regjistrin e GVV-ve.” A jeni dakord me afatin 6-mujor?

**Alban Mësonjësi** – Po, dakord!

**Arben Pëllumbi** - Ne ramë dakord për çështjen e afatit, por tashmë e kemi të përcaktuar.

Po, zoti Bushati, fjala është për ju.

**Helidon Bushati** – Atëherë, ju i qëndroni idesë që duhet të merret autorizimi nga ministri? Sipas diskutimeve që janë bërë këtu edhe nga deputetët e opozitës, edhe nga shoqatat thuhet se nuk ka nevojë për autorizim. Në momentin që regjistrohet nga gjykata dhe gjykata i referohet këtij ligji për sa u përket edhe përcaktimeve territoriale, pse duhet të ketë një miratim nga ministri? Mund të ma shpjegoni, sepse ka qenë një nga pikat kryesore që është diskutuar këtu, në këtë komision?

**Alban Mësonjësi** - I nderuar deputet!

Ne kemi vlerësuar edhe praktika të ngjashme të vendeve të Bashkimit Europian, ku ka regjistër për çështje që lidhen me strategjitë lokale, ku përfshihet edhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Pra, këto janë modele të ndjekura edhe në vende të tjera. Gjithashtu, është pjesë e përafrimit.

Gjithsesi, dua të sqaroj që pavarësia e shoqatës është e garantuar. Pra, vërtet ka një regjistër, ku ato janë të listuara, por shoqata e ka pavarësinë e saj të garantuar.

**Helidon Bushati** – Të lutem, përgjigju pyetjes sime, sepse, siç e dini, nuk e kam me shumë qejf këtë pjesë.

Të mbash regjistër është diçka, të japësh autorizim është diçka tjetër, janë dy gjëra komplet të ndryshme. Në momentin që regjistrohet një GVV, absolutisht çdo ministri dhe pa dyshim ministria juaj, si ministri e linjës administrative, duhet të mbajë një regjistër për efekte statistikore dhe çdo elementi që lidhet me funksionimin e GVV-së, por mbajtja e një regjistri, siç thotë legjislacioni europian, është diçka tjetër dhe marrja e autorizimit, që është *Conditional equation*, që të funksionojë GVV-ja, është diçka tjetër. Unë me pyetjen time i referohem autorizimit, kështu që më ktheni përgjigje për autorizimin, jo për regjistrin.

**Alban Mësonjësi** – Autorizimi është një akt administrativ me karakter deklarativ, që prodhon faktin që një organizatë e regjistruar në gjykatë funksionon si GVV. Është një akt i domosdoshëm, sepse është akt deklarativ. Pra, në çdo aplikim, që shoqata do të bëjë, apo kudo që do të shkojë, do të jetë e regjistruar dhe autorizimi i ministrit provon faktin që funksionon si GVV, pra është akt i domosdoshëm. Është një akt administrativ dhe nuk ndërhyr fare në pavarësinë e shoqatës, nuk ka asnjë efekt.

**Helidon Bushati** – Ne nuk jemi duke diskutuar këtu për cenim të autonomisë funksionale të shoqatës. Ne jemi duke thënë që ju, me autorizimin tuaj, krijoni një barrierë artificiale për funksionimin e një shoqate, e cila e merr funksionalitetin e vet juridik, entitetin juridik, bëhet entitet juridik kur e jep gjykata, jo kur e jep ministria. Pse duhet të futet një autorizim i ministrisë, ndërkohë që të gjitha këto dokumentacione paraqiten në gjykatë, si çdo shoqatë tjetër, merr miratimin nga gjykata, sanksionohet juridikisht, merr fuqi të plotë juridike dhe s'ka nevojë të marrë autorizim nga ministri? Apo doni që ministri të dalë mbi gjykatën? A mund të ma shpjegosh pak, të lutem?

**Julinda Bare** – Përshëndetje!

Në gjykatë regjistrohet si OJF, pra si një shoqatë. Në rastin e ministrisë, GVV-ja, sipas parimeve të këtij ligji, duhet të plotësojë të gjitha këto parime që ne kemi në këtë ligj. Në rast se ministria nuk shikon, që këto parime janë përcaktuar, nuk mund të jetë më një GVV, por është thjesht një shoqatë e regjistruar në gjykatë. Në rast se flasim për GVV, duhet të plotësojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ky ligj. Pra, ministria shikon përputhshmërinë e strategjive; objektivave të zhvillimit të zonës, ku do të veprojë kjo organizatë. Pra, ka një ndryshim shumë të madh midis OJF-së të regjistruar në gjykatë dhe GVV-së që plotëson kushtet e këtij ligji. Pra, nuk është thjesht një shoqatë, një OJF e regjistruar, por është një GVV që plotëson kushtet.

**Arben Pëllumbi** – Faleminderit!

Zoti Bushati, të lutem, nuk jemi në fazë diskutimesh, i kemi bërë këto diskutime. Nëse ju mendoni, dilni me një propozim konkret, që ne të na duhet ta votojmë më pas. Unë, për respekt, jua lejoja ta bëjmë këtë debat, por ne e kemi diskutuar, e kemi konsumuar dhe tani jemi në fazë votimi. Nëse ju keni një propozim konkret, na i thoni. Gjithsesi, përfaqësuesit e ministrisë jua dhanë një shpjegim, sikurse ata e mendojnë dhe e kanë shkruar këtu në ligj.

**Helidon Bushati** – Këto mendimet tuaja shteruese nuk është se kanë pasur shumë efektivitet, por megjithatë ju mund të vazhdoni si anëtare zëvendësuese duke pasur mendime joshteruese. Për efektin shterues, pastaj, mund të diskutojmë, sepse është koncept i gjerë dhe dikush e kupton ndryshe, dikush tjetër e kupton ndryshe.

Ju pa dyshim keni forcën e votës, por jo të mendimit.

Ideja është që, menduam se ju, siç e kemi thënë dhe po e themi, do të reflektonit, për disa elemente dhe ligjin në përgjithësi ne ishim dhe jemi kundër. Ne nuk jemi kundër organizimeve lokale, ne nuk jemi kundër mundësisë që entitetet lokale të aksesojnë fonde të donatorëve, përkundrazi jemi dhe do të jemi pro tyre në vazhdimësi, kemi kaluar ligjin për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe dhamë edhe miratimin tonë, sepse jemi për zhvillimin

ekonomik. Ne nuk jemi për autorizim të ministrisë, po e them përsëri dhe nuk e them thjesht për politikë, por sepse do të ndodhemi në këto situata, që autorizimi i ministrit do të kondicionojë se kujt do t'i jepet statusi i GVV-së në një zonë të caktuar dhe GVV-të do të jenë gjithmonë marioneta të ministrisë apo të qeverisë. Ky është problemi ynë. Ne duam që autonomia e GVV-ve të jetë e plotë dhe ju, me këtë ligj, nuk e garantoni këtë autonomi, përkundrazi e kufizoni akoma edhe më shumë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Arben Pëllumbi** – Unë e përsërita edhe njëherë, i kemi bërë debatet për këtë pjesë dhe ju e keni shprehur mendimin tuaj. Propozuesi sqaroi që fakti që regjistrohesh në gjykatë dhe je një OJF, jo detyrimisht të bën GVV. Që të bëhesh GVV, duhet që dikush tjetër përtej gjykatës të shqyrtojë kriteret, që duhet të plotësosh për të qenë një GVV dhe, sigurisht, vetëm ministria mund ta bëjë këtë punë.

*(Zoti Bushati ndërhyr pa mikrofon.)*

Jo, nuk janë bërë GVV-të.

*(Zoti Bushati ndërhyr pa mikrofon)*

Jemi te neni 15.

Kush është dakord me nenin 15, me riformulimin e bërë nga shërbimet e komisionit? Kundër? 5 kundër. Abstenim?

Miratohet.

Më vjen keq, zoti Bushati, që deshëm t'ju vëmë në dukje numrat.

Kalojmë te neni 16, i cili nuk ka ndryshime.

Kush është dakord me nenin 16, sipas propozimit të Këshillit të Ministrave? 8 pro. Kundër? 5 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 17, ku kemi një riformulim të bërë nga shërbimet e Kuvendit.

Propozues, jeni dakord me këtë riformulim të bërë nga shërbimet e Kuvendit?

**Alban Mësonjësi** - Po, dakord jemi, kryetar.

**Arben Pëllumbi** – Dakord.

**Xhemal Mziu** – Nuk po merrem shumë me komentet e tjera, që kemi bërë gjatë seancave, por po më bën përshtypje që të gjitha ndryshimet që ofrohen, nuk po arrij as t'i lexoj, por direkt: “me leje, kryetar, po...”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të papërgatitur kemi qenë edhe për pyetje që kemi bërë, ti nuk je e azhonuar, mos luaj rolin ...

Në komunikimin që kemi bërë edhe me drejtorin, ne i kemi adresuar pyetje dhe nuk i kemi marrë përgjigjet as javën pasardhëse, kurse në këtë moment jepini 2 minuta kohë vetes, të paktën mos u bëni kaq “vegël e bindur”, sepse ulni autoritetin e përfaqësimit.

**Arben Pëllumbi** – Zoti Mziu, keni të drejtë për këtë gjë, por keni qenë i pavëmendshëm, kur unë fillova fjalën time dhe ju thashë që ka propozime të bëra nga Komisioni i Jashtëm, nga grupet e interesit dhe nga shërbimet e komisionit, të cilat janë rakorduar me propozuesit. Pra, propozimet e ardhura nga shërbimet e komisionit, janë rakorduar me ministrinë, pra ata nuk po i dëgjojnë sot.

**Xhemal Mziu** – Atëherë, mos merrni miratim fare, meqë i kanë miratuar.

**Arben Pëllumbi** – Procedura e kërkon që të shprehet këtu miratimi, jo jashtë kësaj zyre, kështu që për sa kohë procedura e kërkon kështu, ata janë dakord...

**Xhemal Mziu** – Minimalisht duhet argumentuar edhe pse po, edhe pse jo. Ai thjesht luan rolin e nxënësit të klasës së parë, domethënë nuk të jep as mundësinë e mbylljes së fjalisë nga ty, për të t’u shprehur “po”. Duket paksa qesharake, megjithatë është elektrizuar kaq shumë administrata, saqë e shohin partinë si të vetmen shpresë.

**Arben Pëllumbi** – Zoti Zëvendësministër, keni kërkuar fjalën?

**Dhimitër Kote** – Për çështje kohe, ne edhe me komisionin që ishim dje rakorduar, por edhe me administratën këtu kemi rakorduar dhe kemi bërë debat dhe realisht kemi ardhur të përgatitur, sepse edhe ju e keni filtruar këtë gjë me imtësinë më të madhe dhe kjo tregon përgjegjshmërinë që ka ky komision dhe ne ndihemi mirë kur ka debat. Realisht, ndihemi mirë, sepse është një ligj që do të ngelet dhe do të vazhdojë të ketë jetëgjatësi. Kështu që, është normale të ketë debat të tillë me opozitën, sepse opozita është “roje e papaguar” dhe më pëlqen të ketë debat. Ky është një ligj që do të vazhdojë dhe ka të bëjë me vazhdimësinë e aktivitetit të këtyre komuniteteve në këtë shoqëri.

Unë, duke qenë pjesë e biznesit bujqësor dhe pjesë e bujqësisë, pavarësisht pozicionit, mendoj që do të shërbejë dhe do ta nxisë këtë gjë, si një eksperiencë që unë e kam parë edhe në disa vende të tjera të Bashkimit Europian dhe shoqëria jonë, por edhe bujqësia, sektori që ne mbulojmë, e ka të domosdoshme dhe të nevojshme. Unë i quaj shumë dashamirëse dhe shumë korrekte ndërhyrjet dhe më vjen mirë që deputetët këtu po përpiqen, që të dalë një produkt shumë i mirë. Realisht, specialistët tanë janë ulur dhe edhe me Komisionin e Integritetit, por edhe me administratën këtu dhe kanë debatuar për të nxjerrë një produkt sa më të mirë.

Faleminderit!

**Arben Pëllumbi** – Faleminderit, zoti Kote!

E vlerësojmë gjithmonë fjalën tuaj.

Jemi te neni 17.

Kush është dakord me nenin 17, sipas riformulimit të bërë nga shërbimet e Kuvendit dhe të dakortësuar me propozuesin? 8 pro. Kundër? 5 kundër. Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. “Dispozitat e fundit, aktet nënligjore”.

Kemi një saktësim në nenin 18: “Shprehja 15, pika 3 të hiqet dhe shprehja 17, pika 4 të bëhet 17, pika 3”.

Jeni dakord edhe me këtë? Dakord.

Kush është dakord me nenin 18, sipas këtij saktësimi që sapo lexova? 8 pro. Kundër? 5 kundër. Abstenim?

Miratohet.

Neni 19. “Hyrja në fuqi”; “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Kush është pro? 8 pro. Kundër? 5 kundër. Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”.

Kush është pro? 8 pro. Kundër? 5 kundër. Abstenim?

Miratohet.

Ju faleminderit, kolegë!

Punë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**